



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:085639

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06715801

P.nr.236/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale, ndaj të pandehurit Sh.Xh, nga komuna e Pejës, i akuzuar për shkak të veprës penale “*Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme*” nga neni 320 paragrafi 2 nën par 2.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.2296/2023, të datës 20.03.2024, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.12.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, si dhe i pandehuri Sh.Xh, me datë 18.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

SH.XH, i lindur me datën, në fshatin, me vendbanim në rr. “.....”, nr....., në Pejë, nga i ati I. dhe e ëma Sh., e gjinisë, i pa martuar, i gjendjes ekonomike të dobët, niveli i shkollimit i mesëm, i identifikuar me numër personal, posedon nr.tel....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me datë 14.11.2023, në kohë të pavërtetuar, në, Komunës së Pejës, uzurpon pronën e paluajtshme të të dëmtuarës Institutit Bujqësor të Kosovës dhe atë parcelën me nr. ZK-, në atë mënyrë që edhe pse i pandehuri është në dijeni se prona e

lartcekur është e të dëmtuarës Institutit Bujqësor të Kosovës, uzurpon pjesën prej 1 hektarë të asaj prone dhe në të njëjtën në vitin 2017, ndërton objekt,

- Me çka ka kryer veprë penale **“Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme”** nga neni 320 paragrafi 2 nën par 2.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70 dhe 320 paragrafi 2 nën par. 2.1 të KPRK-së, si dhe neni 364, 449, të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I.** Me DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit prej një (1) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri, brenda periudhës së verifikimit të cekur si më lartë, kryen veprë tjetër penale, dënimi i kushtëzuar si në pikën I të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- III.** URDHËROHET i pandehuri, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të liroi pronën e të dëmtuarit të përshkuar si në dispozitiv dhe atë parcelën me nr., në sipërfaqe prej, dhe atë nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.
- IV.** I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit.
- V.** Pala e dëmtuar, Instituti Bujqësor i Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me datë 20.03.2024 ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.2296/2023, ndaj të pandehurit Sh.Xh, për shkak të veprës penale **“Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme”** nga neni 320 paragrafi 2 nën par 2.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.12.2024, në praninë e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, si dhe të pandehurit Sh.Xh.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale *“Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme”* nga neni 320 paragrafi 2 nën par 2.1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, konsideroj se i plotëson kushtet pasi që i njëjti ka mbështetje edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozojë gjykatës që të njëjtit t’ia aprovojë.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitat ligjore të nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjënë mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i Policisë A.B. #6031, i datës 14.11.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje të dyshuarit, i datës 28.07.2023; 1 (Një) foto; Procesverbali i marrjen në pyetje të pandehurit në procedurë paraprake, i datës 15.03.2024*, ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha ka deklaruar së: *sa i përket rrethanave lehtësuese i propozoj gjykatës që të marr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ndërkaq si rrethanë rënduese ndonjë dënim eventual të mëparshëm të të pandehurit.*

I pandehuri Sh.Xh, ka deklaruar së: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të tentoj të ndërtoj diçka tjetër në atë parcelë, pasi që e kuptoj që kjo është veprë penale, kjo tokë me parë ka qene në emër të K.S., fqinjët tonë, mirëpo toka ka qene parcelë e familjes tonë për gjenerata të tëra.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme*” nga neni 320 paragrafi 2 nën par 2.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, shprehjen e pendimit dhe keqardhjen për veprën penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të tentoj të ndërtoj diçka tjetër në atë parcelë, pasi që e kupton që një veprim i tillë paraqet veprë penale, sjelljen e tij korrekte në gjykatë ndërkaq si rrethana rënduese përtej elementeve të veprës penale gjykata nuk konstatoi në këtë rast.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se

vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të tij e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Andaj, mbi këto arsye, gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me burgim të kushtëzuar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 184 paragrafi 1 e lidhur me nenin 48 paragrafi 2 dhe 3 të KRPK-së.

Në kuptim të nenit 50 paragrafi 2 të KRPK-së, gjykata do të revokojë dënimin e kushtëzuar nëse i pandehuri kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, andaj ka vendosur si në pikën e II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pasi që gjykata të pandehurin e shpalli fajtor për veprën penale të njëjtin e urdhëroi që ta liroi pronën e uzurpuar të përshkuar si në dispozitiv të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ndaj të dëmtuarës Instituti Bujqësor i Kosovës, andaj vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2, dhe nën paragrafi 2.6, nenit 450 dhe 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata konform dispozitës së nenit 463 të KPPK-së, të dëmtuarin Institutin Bujqësor të Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, e udhëzoi në kontest të rregullt civil.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr. 236/24, me datë 15.01.2025.

Zyrtarja ligjore
Blerinda Laiq

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerta KERMENDI

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.